



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 20.06.2025  
Numër Protokoli: 4252/2025

A.nr.714/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-Kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.714/2025 të datës 24.04.2025 të parashtruar nga ankuesi D.G, kundër Vendimit Nr.706 të datës 28.03.2025 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Transfer*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.06.2025 mori:

## V E N D I M

**I. Refuzohet** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.714/2025 e datës 24.04.2025 e parashtruar nga ankuesi D.G.

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi Nr.706 i datës 28.03.2025 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil, D.G (*tani e tutje referuar: ankuesi*), e cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me datë 24.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është protokolluar me numër: 2711/2025 nën shenjën A.nr.714/2025, kundër Vendimit Nr.706 i datës 28.03.2025 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik DMZP/MPB.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa Këshilli më datë 13.05.2025 ka pranuar nga kjo e fundit përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit, me datë 29.05.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:3607/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjën A.nr.714/2025 të datës 24.04.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2711/2025 e parashtruar nga ankuesi më datën 24.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Kryetarit të Këshilli VK/2025 të datës 29.05.2025; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin Nr.706 të datës 28.03.2025 të DMZP-së; Mendimin e Avokatit të Popullit të datës 07.08.2024; Vendimin Nr.706 të datës 28.03.2025 të DMZP-së; Akt Emërimit e ankuesit të datës 03.10.2016; Shkresë e datës 06.02.2015 e DASHC-së; Vendimin e Këshillit, A/02/178/2016 të datës 04.08.2016; E-mailin e datës 24.04.2025 të ankuesit dërguar në Këshill; kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 28.04.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 13.05.2025; Akt Emërimit e ankuesit të datës 15.02.2024; Diplomë e datës 19.09.1996 me Nr.210; Diplomë e datës 12.011.2019 me Nr.106; Diplomë e datës 15.12.2008 me Nr.40; Vendimin e datës 27.12.2024 të Drejtorit të DMZP-së; Raportin e punës të datës 25.03.2025 të Komisionit të Ristrukturimit të MAPL-së; E-miali i datës 16.06.2025, Përshkrimi i detyrave të punës dhe kriterëve për pozitën Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave; E-maili dhe kërkesa e ankuesit e datës 09.06.2025.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit D.G është **e pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara në këtë çështje administrative nga palët respektive në këtë procedurë administrative, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, gjegjësisht sipas Akt Emërimit AE.nr.10/2024 të datës 15.02.2024, i njëjti mbanë pozitën e punës “*Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave*”, në kuadër të Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, kurse ndaj të njëjtit Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ka nxjerrë Vendimin me shifër Nr.706 i datës 28.03.2025 përmes të cilit ankuesin e ka transferuar në pozitën “*Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave*” përkatësisht në pozitë të njëjtë që ka mbajtur sipas aktemrimit të potencuar më lartë në kuadër të të njëjtit organ të punësimit, respektivisht DMZP-ja, nxjerrjen e vendimit për transfer sipas detyrës zyrtare e ka mbështetur në Raportin e Punës Nr.Pro.648 të datës 25.03.2025 të Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se procedura e ristrukturimit dhe lëshimi i aktit të kontestuar të datës 26.03.2025 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, është përcjellë me shkelje të dispozitave të ligjit për zyrtarët publik, dhe se transferimi është bërë në kundërshtim me nenin 63, 64, dhe 66 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, po ashtu i njëjti pretendon se transferimi i tij nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal është bërë në kundërshtim me Rregulloren Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil dhe Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili nuk ka qenë në fuqi dhe është diskriminues për ankuesin, si dhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikim asaj kohe nuk e ka zbatuar në plotni vendimin e Këshillit A.nr.1237/2023 si në pikën III të dispozitivit, ndërsa ankuesi me datë 09.06.2025 Këshillit i është drejtuar me kërkesë për reflektim lidhur me moszbatimin e vendimit të plotë të Vendimit të Këshillit A.nr.1237/2023.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit administrativ konstatoi se Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 30.08.2024 ka miratuar Rregulloren (ZKM) Nr.17/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, nga konstatohet fakti se pozita e ankuesit “*Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave*” të cilën e ka mbajtur sipas aktit të emërimit që nga data 15.02.2024 ka mbetur e përcaktuar edhe me ndryshimin e ri në organizmin e brendshëm, respektivisht një çështje e tillë konstatohet me nenin 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 i së njëjtës dhe rregullore, si dhe Organogramin apo Strukturën Organizatave si shtojcë apo pjesë përbërëse e Rregullores Nr.17/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimit të Vendeve të Punës në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Tutje, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me datë 27.12.2024 përmes Vendimit Nr.2565/2024 ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për MAPL, në përbërje prej tre (3) anëtarësh, ku njëri prej tyre është nga radhët e DMZP-së-Kryesuese, dhe dy anëtarë të tjerë nga radhët e MAPL-së.

Në vështrim të pretendimeve të ngritura ankimore nga ankuesi, Kolegji i Këshillit analizoi Raportin e Punës Nr.Pro.648 të datës 25.03.2025 të Komisionit të Ristrukturimit të MAPL-së, mbi bazën e të cilit është nxjerrë akti i kontestuar dhe konstatoi se sipas pikës I të të njëjtit raport, Propozimet e Komisionit për Pozitat e Udhëheqësve të Departamenteve, Udhëheqësve të Divizioneve dhe Zyrtarëve të Nivelit Profesional 1, 2, 3 të cilëve nuk u janë prekur pozitat nga ristrukturimi, dhe konstatoi se ankuesi, veçse ka qenë duke e ushtruar të njëjtën pozitë sipas Akt Emërimit AE.nr.10/2024 të datës 15.02.2024, nga rrjedhe se të njëjtit vetëm se iu ka rikonfirmuar marrëdhënia e punës në kuadër të së njëjtës pozitë, kategori dhe klasë, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e nenit 66 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: “1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori; 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës” dhe konstatoi se ankesa e ankuesit nuk është e bazuar, pasi që

ankuesi pozitën në fjalë ka qenë duke e ushtruar sipas Akt Emërimit AE.nr.10/2024 të datës 15.02.2024, dhe për rrjedhojë sipas Përshkrimit të detyrave dhe kriterëve të aprovuara nga Sekretari i përgjithshëm i MAPL-së, për pozitën përkatëse ndër tjerash në fushën e kualifikimit arsimor parashihet: “*Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (bachelor) në fushën: Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike*”, kurse nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi posedon Diplomën e datës 19.09.1996 me Nr.210 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, sipas së cilës arrihet në konstatimin se i njëjti me datë 22.02.1996 ka mbaruar Fakultetin Filozofik-Dega e Historisë, nga rrjedh se i njëjti, i ka plotësuar kriteret përkatëse të kualifikimit arsimor për pozitën në fjalë, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 66 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, andaj pretendimi ankimor i ankuesit është refuzuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa akti i kontestuar, respektivisht Vendimi i datës 28.03.2025 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si dhe Raporti i Punës Nr.Pro. i datës 25.03.2025 i Komisionit të Ristrukturimit i MAPL-së, që ndërlidhet me transferimin e ankuesit është i ligjshëm në kuptim të dispozitave nga neni 66 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Meqenëse ankuesi ka ngritur pretendime ankimore përtej objektit të kësaj çështje administrative, respektivisht përtej kontestimit të nxjerrjes së Vendimit Nr.706/2025 të datës 28.03.2025 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, Kolegji i Këshillit thekson faktin se pozita “*Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave*”, në të cilën ankuesi është sistemuar, është pozita të cilën ankuesi e mban sipas Akt Emërimit AE.nr.10/2024 të datës 15.02.2024, dhe i njëjti akt emërim është nxjerrë mbi bazën e Vendimit Nr.603 të datës 13.02.2024 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP), gjegjësisht DMZP Vendimin e datës 13.02.2024 me numër:603 e kishte nxjerr me qëllim të zbatimit të Vendimit të Këshillit A.nr.1237/2023 të datës 01.12.2023.

Këshilli asaj kohe përmes vendimit A.nr.1237/2023 të datës 01.12.2023 e kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e datës 02.10.2023 të parashtruar nga ankuesi, ashtu që ishte aprovuar pretendimi ankimor lidhur me kontestimin e kompetencës së organit që ka nxjerrë vendimin e kundërshtuar, gjegjësisht Vendimin me numër protokolli Nr.prot.2357 i datës 20.09.2023 të Ministres së Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërsa pretendimin ankimor lidhur me kthimin e ankuesit në pozitën e punës “*Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit*” sipas Akti të Emërimit të datës 03.10.2016 e kishte refuzuar pas konstatimit se pozita respektive hynë në kuadër të kategorisë së lartë drejtuese dhe se për pozitat e tilla sipas ligjit material për Shërbimin Civil nuk mund të ushtrohen me mandat të përhershëm dhe mbi këtë bazë e kishte obliguar Qeverinë e Republikës së Kosovës-Ministrinë e Punëve të Brendshme, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të bëjë sistemimin e ankuesit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pikëpamjet juridike të Vendimit A.nr.1237/2023, e që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me rastin e nxjerrjes së Vendimit me shifër: 603/2024 të datës 13.02.2024 përmes të cilit e ka bërë sistemimin e tij në pozitën “*Drejtor i Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave*” në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, e ka zbatuar vendimin e Këshillit A.nr.1237/2023.

Është për tu theksuar fakti se ankuesi kundër Vendimit të Këshillit A.nr.1237/2023 kishte hapur konflikt administrativ, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative me datë 21.05.2024 përmes Aktvendimit A.nr.339/2024 e ka refuzuar propozimin e paditësit për shtyrje të egzekutimit të vendimit të këshillit. Ankuesi kundër Aktvendimit A.nr.339/2024 të datës 21.05.2024 kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ndërsa kjo e fundit përmes Aktvendimit AA.nr.667/2024 të datës 08.07.2024 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit/propozuesit, ndërsa e ka vertetuar Aktvendimin A.nr.339/2024 të datës 21.05.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, andaj edhe kolegji i këshillit duke marrë për bazë faktin se vendimi i këshillit A.nr.1237/2023 të datës 01.12.2023 është bërë i egzekutueshëm, duke u konfirmuar egzekutueshmëria e vendimit edhe përmes aktvendimeve të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit.

Po ashtu, ankuesi kundër Vendimit Nr.603 të datës 13.02.2024 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrarëve Publik (DMZP), përmes të cilit ishte transferuar në pozitën që mban aktualisht *Drejtor i Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave* në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, kishte parashtruar ankesë në Këshilli me datë 23.02.2024, mirëpo të njëjtën ankesë përmes parashtrësës së datës 29.02.2024, ndërsa Këshilli duke marrë për bazë plotësimin dhe ndryshimin e ankesës së tij përmes parashtrësës së datës 29.02.2024 kishte konstatuar se pretendimet e ngritura nga i njëjti janë shqyrtuar dhe vendosur përmes Vendimit të Këshillit A.nr.1237/2023 të datës 01.12.2023, prandaj duke marrë parasysh dispozitat e aplikuara të nenit 21 paragrafi 1 dhe 2, si dhe nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 ku përcaktohet se:

*“21.1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës; 22.2. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Këshillit; 22.1. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ. 2. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit”, Kolegji i Këshillit kishte vendosur që të përfundon procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.269/2024 të datës 23.02.2024, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 101 paragrafi nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “1. Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike” dhe për rrjedhojë Vendimi i datës 13.02.2024 me numër:603 i DMZP-së është bërë i ekzekutueshëm, ndërsa pala ankuese është udhëzuar në mjete juridike për hapjen e konfliktit administrativ sipas bazës ligjore në fuqi.*

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, konstatoi se akti i kontestuar nga pala ankuese, respektivisht Vendimi Nr.706 i datës 28.03.2025 i Departamentit për

Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme ashtë akt administrativ i ligjshëm pasi që i njëjti është nxjerrë në frymën dhe mbështetjen e nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “8.1. Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunëses/it civil, nëpunëses/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mosdiskriminimit” ndërlidhur me nenin 66 paragrafi 4 i të njëjtit ligj, pasi që procesi i sistemit të ankuesit që lidhet me procesin e transferimit për shkak të ristrukturimit të MAPL-së, është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara nga e neni 66 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, sikurse u konstatuar dhe u pasqyruara edhe më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, dhe për rrjedhojë ankesa e ankuesit e datës 24.04.2025 është refuzuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi pasi që e njëjta nuk gjenë mbështetje në dispozitat e aplikuara të ligjit material, ndërsa akti i kontestuar nga ankuesi është lënë në fuqi, pasi që i njëjti ishte nxjerrë në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik të shprehura si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda, A.nr.714/2025, datë 20/06/2025**

**Flakron GASHI**

\_\_\_\_\_  
**Procesmbajtës**

**Arben MEHMETI**

\_\_\_\_\_  
**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit D.G;
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (*Sekretarit të Përgjithshëm, Komisionit të Ristrukturimit dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore*),
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.